



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë 14.09.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional – MPN, në bashkëpunim me bashkëpunëtorin e jashtëm, përfaqësuesin e Shoqatës për të Drejtë Penale dhe Kriminologji të Republikës së Maqedonisë, realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor Veles.

Vizita e ekipit të MPN-së në SP Veles u realizua në kuadër të mandatit të Avokatit të Popullit - Mekanizmit Parandalues Nacional i cili buron nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet se MPN-ja realizon vizita të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë kësaj vizite në SP Veles kishte bashkëpunim konstruktiv nga ana e personave zyrtarë dhe realizoi këqyrje papengesë në të gjitha hapësirat dhe dokumentet.

Nga ana e ekipit të MPN-së nuk u vërejtën sende në hapësirat zyrtare të stacionit, magazinat dhe automjetet të cilat do të mund të përdreshin për dhunë ose frikësim.

Gjatë kësaj vizite, ekipi i MPN-së konstatoi se personat zyrtarë mbajnë trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme me përmbajtje të ndryshme tematike.

Gjatë këqyrjes së realizuar, ekipi i MPN-së konstatoi se në hyrje të SP Veles nuk ka rampë për persona me aftësi të kufizuar, me çka këtyre personave u vështirësohet aksesin deri te stacioni policor dhe deri te hapësirat zyrtare.

Ekipi i MPN-së, gjithashtu, konstatoi se në Stacionin Policor Veles nuk ka hapësirë të posaçme për marrje në pyetje të personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria. Njëkohësisht, MPN-ja konstatoi se në SP Veles nuk ka hapësirë të

posaçme për ndalimin e personave të mitur, në përputhje me Ligjin për të drejtat e fëmijëve.

Ekipi i MPN-së, gjatë kësaj vizite, vërejti se hapësirat për ndalim në SP Veles janë në gjendje të keqe materiale dhe nuk i përmbushin standardet minimale të parashikuara për ndalimin e personave. Gjithashtu, konstatoi se asnjëra nga hapësirat në të cilat kryet marrja në pyetje e personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria nuk disponojnë me për audio dhe video monitorim.

Gjatë vizitës, ekipi i MNP konstatoi se hapësira për identifikimin e personave gjendet në largësi të madhe nga hapësirat e ndalimit, ndërsa për këtë shkak personat të cilët ndalohen në këtë stacion policor në mënyrë të padrejtë u nënshtrohen shikimeve të personave të tretë (palë dhe persona zyrtarë).

Ekipi i MPN, gjithashtu vërejti se nyja sanitare i dedikuar për personat e ndaluar është tërësisht e amortizuar dhe jofunksional dhe për këtë shkak personat e ndaluar dërgohen në tualetin e dedikuar për personat zyrtarë.

Në SP Veles mungon automjeti i veçantë për shoqërimin e personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, të cilët për një kohë më të gjatë kohore presin të servisohet.

Nga këqyrja në regjistra, MPN-ja konstatoi se gjatë evidentimit të kohës së privimit nga liria ose arrestimit dhe evidentimit të kohës së ndalimit, nuk mbahet llogari për rrjedhën kronologjike të ngjarjeve.

Për këtë vizitën Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe adresoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te komandanti i Stacionit Policor në SP Veles, me qëllim që të eliminohen mangësitë e konstatuara dhe të përmirësohen kushtet sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.

